

Programi Pas Shkolle – Udhëzues për drejtorin e shkollës

Si të hapni dhe të drejtoni Programin Pas Shkolle, hap pas hapi

Për	Drejtorët e institucioneve arsimore
Sistemi	SMIP
Data	Gusht 2026

Rrjedha me një shikim

1. Krijoni **programin**
2. Krijoni **klubet**
3. Shënoni klubet **“Gati”**
4. **Hapni aplikimet** për mësues
5. **Vlerësoni** aplikimet
6. **Caktoni** mësuesin
7. **Hapni regjistrimet** për prindërit
8. Ndiqni regjistrimet dhe kërkesat e prindërve
9. **Mbyllni regjistrimet** dhe **aktivizoni** programin
10. Në fund, **mbyllni programin**


Punoni në këtë rend. Vetëm dy gjëra janë të detyrueshme: klubet duhet të jenë **“Gati”** para se të pranojnë aplikime dhe regjistrime, dhe çdo klub i publikuar duhet të ketë **mësues** para se programi të aktivizohet.

Hapi 1 — Hapni modulin

Shkoni te: menyja anësore → **Viti Shkollor Aktual** → **Programi Pas Shkolle**

Do të shihni pesë zëra:

Zëri	Për çfarë shërben
Programi dhe klubet	Krijoni programin dhe klubet
Aplikimet e mësuesve	Vlerësoni dhe caktoni mësuesit
Regjistrimet e nxënësve	Shihni nxënësit dhe kërkesat e prindërve
Orari dhe prezenca	Orari, takimet, prezenca
Fletët informuese	Fletët e vlerësimit të nxënësve




Menyja e modulit


Hapi 2 — Krijoni programin

Shkoni te: Programi dhe klubet

1. Klikoni **Shto program**.
2. Zgjidhni **Shkollën**, **Vitin shkollor** dhe **Ciklin arsimor**.
3. Klikoni **Shto**.



Lista e programeve



Formulari i krijimit të programit

Çfarë ndodh: programi krijohet në gjendjen **Draft**. Nëse cikli është **arsim fillor**, sistemi krijon vetë edhe klubin **BDSH**.

Kujdes. Programi nuk mund të modifikohet më vonë. Nëse zgjidhni gabim shkollën, vitin ose ciklin, i vetmi korrigjim është ta **anuloni** programin dhe të krijoni një të ri.

Hapi 3 — Krijoni klubet

Shkoni te: programi → ikona **Shiko programin**

1. Klikoni **Shto klub**.
2. Plotësoni **Emrin**, **Përshkrimin**, **Kapacitetin** dhe **Numrin maksimal të mësuesve**.
3. Nëse doni, zgjidhni një **model klubi** — ai plotëson vetë fushat, të cilat mund t'i ndryshoni.
4. Klikoni **Shto**.

Formulari i klubit

Rregullat që zbaton sistemi:

- kapaciteti duhet të jetë **midis 20 dhe 30** nxënës;
- programi mund të ketë **maksimumi 5 klube**;
- për të hapur regjistrimet, duhen **të paktën 2 klube** të shënuara “Gati”;
- emri i klubit nuk mund të përsëritet brenda programit.

Kujdes me numërimin. Kufiri prej **5 klubeve** numëron edhe klubet që i keni lënë në **Draft**. Kërkesa prej **2 klubeve** numëron vetëm ato të shënuara “Gati”. Një klub i harruar në Draft zë vend, por nuk ju ndihmon të hapni regjistrimet.

Klubi BDSH (“Bëjmë Detyrat e Shtëpisë”) krijohet vetvetiu në arsimin fillor. Për ciklet e tjera mund ta krijoni vetë duke shënuar kutinë **BDSH**. Emri ruhet gjithmonë si “BDSH”, pavarësisht

çfarë shkruani. Ai nuk numërohet ndër 5 klubet dhe nuk hyn në kufirin e nxënësit.

Hapi 4 — Shënoni klubet “Gati”

Shkoni te: programi → rreshti i klubit

Klikoni **Shëno si gati**.

Programi Pas Shkolle

Viti shkollor: 2025-2026

Shkolla: SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ (Zyra Vendore e Arsimit...)

Faqja kryesore > Programi dhe klubet > Detajet e programit

Programi Pas Shkolle

Shkolla: SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ

Cikli arsimor: Arsimi i mesëm i ulët

Regjistrimet e mbyllura: —

Mbyllur: —

Viti shkollor: 2025-2026

Regjistrimet e hapura: —

Aktivizuar: —

Anuluar: —

Hap regjistrimet Anulo

Klubet

Klubi duhet shënuar "Gati" para se mësuesit të aplikojnë dhe nxënësit të regjistrohen. Klubet e gatshme kalojnë në "Aktiv" kur aktivizohet programi.

EMRI	KAPACITETI	MËSUES (MAKS.)	BDSH	APLIKIMET E MËSUESVE	STATUSI
BDSH	Pa kufi	1	Po	Mbyllur	Draft
Klubi i futbollit	30	2	Jo	Mbyllur	Gati
Klubi i artit dhe pikturës	20	1	Jo	Mbyllur	Gati

+ Shto klub

Modifiko klubin

Shëno si gati

Anulo Shëno si gati

Klubi i shënuar “Gati”

Çfarë ndodh: klubi hyn në strukturën e programit dhe mund të pranojë aplikime mësuesish dhe regjistrime nxënësish.


Nëse butoni nuk shfaqet, kapaciteti është jashtë intervalit 20–30, ose programi është mbyllur.

Për ta kthyer një klub në **Draft**, klikoni **Kthe në draft**. Kjo lejohet vetëm nëse klubi nuk ka asnjë nxënë. Aplikimet e dorëzuara nuk humbasin — ato mbeten **Në pritje**.

Hapi 5 — Hapni aplikimet për mësues

Shkoni te: programi → rreshti i klubit

Klikoni **Hap aplikimet**.



Hapja e aplikimeve

Çfarë ndodh: klubi shfaqet te mësuesit e shkollës suaj, te faqja “Apliko për klub”.

Sistemi nuk i njofton mësuesit. Lajmërimi i tyre bëhet nga shkolla, si çdo njoftim tjetër i brendshëm.

Klubi duhet të jetë **“Gati”**. Përndryshe do të lexoni: *“Klubi duhet të shënohet”Gati” përpara se të hapen aplikimet e mësuesve.*”

Hapi 6 — Vlerësoni aplikimet

Shkoni te: Aplikimet e mësuesve

1. Zgjidhni klubin.
2. Për çdo kandidat klikoni **Dokumentet** për të parë portofolin.
3. Klikoni **Vlerëso** dhe jepni pikët për çdo kriter.
4. Klikoni **Ruaj**.

Viti shkollor

2025-2026

Shkolla

SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ (Zyra Vendore e Arsimit...)

Drejtör Shkolle

Mide Uka

Faqja kryesore

Aplikimet e mësuesve

Programi

2025-2026 - Arsimi fillor - Regjistrimet h...

Klubi

BDSH

Aplikimet - BDSH

Mbyll aplikimet

RENDI	MËSUESI	PIKËT	STATUSI	DOKUMENTET	VEPRIME
1	Angjelin Stefo	—	Në pritje	0	
2	Mide Uka	—	Në pritje	0	

Vlerëso aplikimin

✓ Cakto mësuesin

✗ Refuzo aplikimin

Vlerëso aplikimin

Historiku i mësuesve

MËSUESI	NGA	DERI	STATUSI	VEPRIME
Alma Prengëzi	27/08/2026	—	Aktiv	

Rekorde për faqe: 10

Faqja 1 nga 1

<< < > >>

Aplikimet e mësuesve

Kriteret dhe pikët maksimale:


Kriteri	Pikët
Diploma dhe lista e notave	5
Dëshmitë e kualifikimit	10
Certifikatat e trajnimeve me kredite	3
Dëshmia e gjuhës së huaj	2
Libreza e punës	pa tavan
Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve	2
Vlerësimi i shërbimit psikosocial	2
Vlerësimi i drejtorit	2

Çfarë ndodh: sistemi mbledh pikët dhe rendit kandidatët. Në barazim pikësh, renditja ndahet me short.

Hapi 7 — Caktoni mësuesin

Shkoni te: Aplikimet e mësuesve → rreshti i kandidatit

Klikoni **Cakto**.



Caktimi i mësuesit

Çfarë ndodh: kandidati merr klubin dhe klubi bëhet i plotë. Aplikimet e tjera të **të njëjtit mësues** për klube të të njëjtit lloj shënohen vetvetiu **I pazgjedhur**.

Renditja është udhëzuese. Sistemi nuk ju detyron të zgjidhni të parin dhe nuk kërkon që aplikimi të jetë vlerësuar. Vendimi është juaji.

Një mësues mund të drejtojë vetëm një klub të zakonshëm plus një BDSH në shkollën tuaj, brenda një viti shkollor.

Për të refuzuar një kandidat, klikoni **Refuzo aplikimin**.

Hapi 8 — Hapni regjistrimet

Shkoni te: programi

Klikoni **Hap regjistrimet**.

Të Dhënat Baze

Falem Viti Shkollor

Viti Shkollor Aktual

Fund Viti Shkollor

Raporte

Viti shkollor

2025-2026

Shkolla

SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ (Zyra Vendore e Arsimit...)

Drejtor Shkollë

Mide Uka

Faqja kryesore

>

Programi dhe klubet

>

Detajet e programit

Programi Pas Shkolle

Regjistrimet mbyllur

Shkolla: SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ

Viti shkollor: 2025-2026

Cikli arsimor: Arsimi fillor

Regjistrimet e hapura: 27/08/2026 14:31

Regjistrimet e mbyllura: 28/08/2026 12:23

Aktivizuar: —

Mbyllur: —

Anuluar: —

Hap regjistrimet

Aktivizo

Anulo

Klubet

+ Shto klub

Klubi duhet shënuar "Gati" para se mësuesit të aplikojnë dhe nxënësit të regjistrohen. Klubet e gatshme kalojnë në "Aktiv" kur aktivizohet programi.

EMRI	KAPACITETI	MËSUES (MAKS.)	BDSH	APLIKIMET E MËSUESVE	STATUSI
BDSH	Pa kufi	1	Po	Hapur	Gati
Eko-klubi i mjedisit	25	1	Jo	Hapur	Gati
Klubi i gjuhës angleze	25	1	Jo	Hapur	Gati

Hapja e regjistrimeve

Çfarë ndodh: klubet shfaqen te prindërit dhe ata mund të regjistrojnë fëmijët.

Sistemi kontrollon më parë:


- **2 deri në 5 klube** të shënuara "Gati";
- kapacitet të vlefshëm në çdo klub;
- për arsimin fillor, një **BDSH** të shënuar "Gati".

Regjistrimet mund të hapen edhe pa caktuar ende mësuesit. Mësuesit kërkohen vetëm në aktivizim (Hapi 11). Kështu konkurrimi i mësuesve dhe regjistrimi i nxënësve ecin paralelisht.

Hapi 9 — Ndiqni regjistrimet

Shkoni te: Regjistrimet e nxënësve

Aty shihni çdo nxënës me statusin e tij: **Pranuar** ose **Në listë pritjeje**.




Lista e regjistrimeve

Si funksionon radha: kush regjistrohet i pari, zë vendin i pari. Kur lirohet një vend, ai i jepet vetvetiu të parit në listën e pritjes.

Veprimet që keni:

Butoni	Çfarë bën
Hiq	Largon nxënësin; vendi i jepet listës së pritjes
Ngri nga lista e pritjes	Pranon një nxënësin në pritje, nëse ka vend
Zëvendëso	Ndërron një nxënësin të pranuar me një tjetër



Heqja dhe zëvendësimi

Të tria kërkojnë arsye. Arsyeja është e detyrueshme dhe ruhet përgjithmonë, bashkë me emrin tuaj dhe orën.

Pas çdo veprimi, **prindi njoftohet automatikisht.**

Një nxënës mund të jetë në maksimumi 2 klube njëkohësisht. BDSH-ja nuk numërohet.

Hapi 10 — Shqyrtoni kërkesat e prindërve

Shkoni te: Regjistrimet e nxënësve → karta **Kërkesat e pazgjidhura**

Prindërit mund të kërkojnë **tërheqje** ose **transferim**. Klikoni **Aprovo** ose **Refuzo**.

Fëmija

Fëmija: Ersë Hoxha | Shkolla: SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ | Klasa:

Regjistrimet e fëmijës

Regjistrimet

KLUBI	BDSH	STATUSI	NUMRI NË LISTËN E PRITJES	BURIMI	APLIKUAR MË	KËRKESA NË PRITJE	VEPRIME
BDSH	Po	Pranuar	—	Prindi	27/08/2026	—	Transfero Terhiq

Klubet ku mund të regjistrohet

Klubet

KLUBI	BDSH	KAPACITETI	VENDE TË LIRA	VEPRIME
BDSH	Po	Pa kufi	Pa kufi	I regjistruar
Eko-klubi i mjedisit	Jo	25	25	Regjistro
Klubi i gjuhës angleze	Jo	25	25	Regjistro

Fletët informuese të fëmijës

Lista e njoftimeve për fletët informuese të publikuara gjatë 30 ditëve të fundit. Fletët në draft nuk njoftohen dhe nuk shfaqen këtu.

Kur një fletë fletë korrigjohet, publikohet një version i ri që zëvendëson versionin e mëparshëm të së njëjtës periudhë vlerësimi. Periudha nuk njoftohet, prandaj kur për një klub shfaqen disa versione, vlen versioni më i lartë i së njëjtës periudhë — periudha dhe versioni janë të shkruara brenda dokumentit.

Fletët informuese

Kërkesat e prindërve

Çfarë ndodh:

- **Tërheqje e aprovuar** — nxënësi largohet dhe vendi i jepet listës së pritjes.
- **Transferim i aprovuar** — nxënësi kalon në klubin e ri. Nëse klubi i ri është plot, ai hyn në radhë dhe transferimi përfundon vetvetiu kur lirohet një vend.

Transferimi lejohet vetëm **brenda të njëjtit program**.

Hapi 11 — Mbyllni regjistrimet dhe aktivizoni

Shkoni te: programi

1. Klikoni **Mbyll regjistrimet** kur afati mbaron.
2. Klikoni **Aktivizo**.

Çfarë ndodh me aktivizimin: klubet “Gati” kalojnë në **Aktiv** dhe struktura e programit ngrihet — nuk shtoni e nuk modifikoni më klube, dhe prindërit nuk regjistrojnë më.

Aktivizimi kërkon mësues në çdo klub të publikuar. Përndryshe do të lexoni: “Këto klube nuk kanë mësues aktiv: ... Caktoni një mësues ose kthejini në draft.”

Zgjidhja për një klub pa kandidatë është ta ktheni në **Draft**. Klubet në Draft nuk e pengojnë aktivizimin.

Nuk keni nevojë të aktivizoni për të nisur punën. Orari, takimet, prezenca, materialet dhe fletët informuese punojnë që kur regjistrimet janë mbyllur dhe klubet janë “Gati”.

Nëse ju duhet të rihapni regjistrimet, klikoni sërish **Hap regjistrimet**. Lista e pritjes nuk preket.

Hapi 12 — Ndiqni veprimtarinë e klubeve

Shkoni te: Orari dhe prezenca dhe **Fletët informuese**

Në këto dy faqe keni të njëjtat mundësi si mësuesi, por për **çdo klub të shkollës suaj**: orarin javor, takimet, listën e prezencës, materialet, njoftimet dhe fletët informuese.

Hapi 13 — Raportet

Shkoni te: menyja anësore → **Raporte** → **Programi Pas Shkolle**

Zgjidhni raportin dhe filtrat. Raporti gjenerohet vetvetiu — nuk ka buton “Gjenero”.

Raportet e Programit Pas Shkolle

Raporti: Përmbledhje sipas shkollës | Viti shkollor: Zgjidhni vitin shkollor | Cikli arsimor: Të gjitha | Statusi i programit: Të gjitha | Shkolla: Të gjitha

Rreshta gjithsej: 2

Një vizë (–) do të thotë se nuk ka të dhënë, jo zero. Norma e frekuentimit është bosh kur nuk është regjistruar asnjë prezencë, ndërsa vendet e lira dhe norma e plotësimit janë bosh kur klubi është pa kufi – asnjëra nuk do të thotë 0.

Ky raport grupon programe, jo klube: filtri për klubet BDSH nuk zbatohet këtu dhe nuk shfaqet.

SHKOLLA	ZVA	DRAP	VITI SHKOLLOR	CIKLI ARSIMOR	STATUSI I PROGRAMIT	NUMRI I KLUBEVE	NUMRI I KLUBEVE BDSH	NXENËS TË PRANUAR	VALJZA	DJEM
SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ	ZVA Kamëz	DRAP Durrës	2025-2026	Arsimi fillor	Regjistrimet hapur	3	1	1	1	0
SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ	ZVA Kamëz	DRAP Durrës	2025-2026	Arsimi i mesëm i ulët	Draft	3	1	0	0	0

Rekorde për faqe: 10 | Faqja 1 nga 1

Raportet

Raportet e disponueshme: Përmbledhje sipas shkollës, Pjesëmarrja sipas klubit, Pjesëmarrja sipas klasës, Kapaciteti dhe vendet e lira, Lista e pritjes, Frekuentimi sipas klubit, Frekuentimi sipas muajit, Mësuesit e klubeve, Plotësimi i fletëve informuese.

Për të shkarkuar, klikoni **Eksporto**.

programi-pas-shkolle-summary.xlsx
Completed — 6.6 KB
Show all downloads

Raportet e Programit Pas Shkolle

Raport: Përmbledhje sipas shkollës Viti shkolle: Zgjidhni vitin shkolle Cikl i arsimor: Të gjitha Statusi i programit: Të gjitha Shkolla: Të gjitha

Rreshta gjithsej: 2

Një vizë (—) do të thotë se nuk ka të dhënë, jo zero. Norma e frekuentimit është bosh kur nuk është regjistruar asnjë prezencë, ndërsa vendet e lira dhe norma e plotësimit janë bosh kur klubi është pa kufi — asnjëra nuk do të thotë 0.

Ky raport grupon programe, jo klube: filtri për klubet BOSH nuk zbatohet këtu dhe nuk shfaqet.

SHKOLLA	ZVA	DRAP	VITI SHKOLLOR	CIKLI ARSIMOR	STATUSI I PROGRAMIT	NUMRI I KLUBEVE	NUMRI I KLUBEVE BOSH	NXËNËS TË PRANUAR	VAJZA	DJEM
SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ	ZVA Kamëz	DRAP Durrës	2025-2026	Arsimi fillor	Regjistrimet hapur	3	1	1	1	0
SHKOLLA 9-VJEÇARE "100 VJETORI" KAMËZ	ZVA Kamëz	DRAP Durrës	2025-2026	Arsimi i mesëm i ulët	Draft	3	1	0	0	0

Rekorde për faqe: 10 Faja 1 nga 1

Eksporti

Kujdes me raportet e mëdha. Raporti ndalet në **5.000 rreshta**. Në ekran shfaqet një paralajmërim, por **skedari Excel nuk e mban atë paralajmërim**. Nëse e shihni, ngushtoni filtrat përpara se ta përdorni si shifër zyrtare.

Një **vizë (—)** do të thotë “nuk ka të dhënë”, jo zero.

Hapi 14 — Mbyllni programin

Shkoni te: programi

Klikoni **Mbyll programin** dhe konfirmoni.

Çfarë ndodh: klubet aktive mbyllen, klubet në Draft ose Gati anulohen, regjistrimet dhe caktimet përfundojnë, dhe prindërit njoftohen.

Mbyllja nuk e liron vendin. Pas mbylljes nuk mund të krijoni një program të dytë për të njëjtën shkollë, vit dhe cikël. Vetëm **anulimi** e liron atë vend.

Për të **anuluar** një program ose klub, klikoni **Anulo** dhe shkruani arsyen. Anulimi është përfundimtar.

Gabimet më të shpeshta

Mesazhi	Çfarë të bëni
<i>Programi duhet të ketë midis 2 dhe 5 klube ... Aktualisht ka N.</i>	Shënoni edhe klube të tjera si “Gati”.
<i>Programi i arsimit fillor duhet të ketë një BDSH të shënuar “Gati”.</i>	Shënoni BDSH-në si “Gati”.
<i>Kapaciteti i klubit duhet të jetë midis 20 dhe 30.</i>	Ndreqni kapacitetin.
<i>Këto klube nuk kanë mësues aktiv: ...</i>	Caktoni mësues, ose kthejini ato klube në Draft.
<i>Klubi duhet të shënohet “Gati” përpara se të hapen aplikimet e mësuesve.</i>	Shënoni klubin si “Gati” më parë.
<i>Ekziston tashmë një program aktiv për këtë shkollë, vit shkollor dhe cikël arsimor.</i>	Programi ekzistues, edhe i mbyllur, e zë vendin. Anulojeni nëse doni një të ri.
<i>Klubi është plot; nuk mund të tejkalohet kapaciteti.</i>	Nuk ka vend të lirë. Rritni kapacitetin ose prisni një largim.
<i>Nuk keni të drejta për të kryer veprimin</i>	Nuk ushtroni detyrë drejtori në atë shkollë.